

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 1/3

PSB, 24.11.2021

Titulli i DPS/KT: 129

Qelqi

Mjedisi i biznesit

Tregu i xhamit në ndërtimin mbulon të gjitha llojet kryesore të prodhimeve të qelqit, të veçanta dhe të përpunuara, të destinuara për përdorim në ndërtesa në situata të ndryshme në mbarë botën, të cilat janë të ekspozuar ndaj një gamë të gjerë të kushteve klimatike dhe mjedisore

Industria evropiane e xhamit të sheshtë (fletëve të xhamit) përfaqëson pak a shumë një të tretën e tregut të përgjithshëm të fletëve të xhamit (përfshirë xhamin e laminuar).

KT 19 në DPS, adopton standarde evropiane dhe ndërkombëtare si dhe bën standarde puro shqiptare për sa i përket përcaktimit dhe vlerësimit të konformitetit të produkteve të xhamit të sheshtë dhe atij të përpunuar si dhe për metodat e smaltimit.

Ndërsa në rang ndërkombëtar shitjet totale të produkteve të qelqit për përdorim në ndërtim (kryesisht xhami i trajtuar për banesa) gjatë viteve të fundit janë vlerësuar në rreth 40 bilion sterlina. Grupet me të mëdha konsumatore në treg për sa i përket produkteve me bazë xhami janë:

Industria e banesave	40 %
Tregtia	40 %
Industria	20 %

Palët e përfshira në këtë proces janë: ndërmarjet e prodhimit të fletëve të xhamit, xham vendosësit, laboratorët dhe trupat e testimit.

Përfitimet

Aktiviteti i standardizimit në KT 129 ka rezultuar i dobishëm në uljen e kostos në industrinë e ndërtimit dhe ka dhënë një ndihmesë të madhe në drejtim të:

- Mënjanimit të barrierave në tregëti me anë të adoptimit të specifikimeve dhe procedurave të njëjta testimi për produktet e qelqit,
- Ndihmesës që i jepet sektorit specifik të ndërtimit dhe projektimit duke shmangur konfuzionin e shkaktuar nga përdorimi i standardeve të ndryshme kombëtare.

Prioritetet

Duke qënë së puna e KT 129 në DPS bazohet kryesisht në adoptimin e standardeve evropiane EN dhe atyre ndërkombëtare ISO prioritetet e këtij KT 129 janë:

1. adoptimi 100% i standardeve evropiane të fushës së qelqit për të përmbushur detyrimin për pranimin me të drejta të plota në CEN;
2. adoptimi në masë të konsiderueshme të standardeve të ISO;



3. të ndjekë dhe të marrë pjesë aktive në punën e Komitetit Teknik të CEN me ane të afrimit të specialistëve të saj në punën e këtij KT
4. Të sigurohemi se si të gjitha vëndet e tjera të ndjekim të njëjta regulla të CPD për të mos krijuar bariera në tregëti

1. Mjedisi i Biznesit i KT/DPS

1.1 Përshkrimi i mjedisit të biznesit

Politikat e ndjekura, ekonomike, teknike, regullatore, ligjore dhe sociale përshkruajnë mjedisin e biznesit në sektorin industrial, atë të produkteve, materialeve, disiplinës ose praktikave që kanë të bëjnë me objektin e këtij KT dhe mund të kenë ndikim të rëndësishëm në mënyrën se si drejtohen proceset e bërjes së standardeve, si dhe në përmbajtjen përfundimtare të standardeve.

Industria evropiane e xhamit të sheshtë (fletëve të xhamit) përfaqëson pak a shumë një të tretën e tregut të përgjithshëm të fletëve të xhamit (përgjashtuar xhamin e laminuar).

KT 19 në DPS, adopton standarde evropiane dhe ndërkombëtare si dhe bën standarde puro shqiptare për sa i përket përcaktimit dhe vlerësimit të konformitetit të produkteve të xhamit të sheshtë dhe atij të përpunuar si dhe për metodat e smaltimit

Palët e përfshira në këtë proces janë: ndërmarjet e prodhimit, përpunimin, lustrimit të fletëve të xhamit, xham vendosësit, laboratorët dhe trupat e testimit.

1.2 Treguesit sasiorë të mjedisit të biznesit

Përmbledhja e më poshtëme mbi treguesit sasiorë përshkruan mjedisin e biznesit me qëllim që të japë një informacion të përshtatshëm për mbështetjen e punës të KT 129 në DPS.


Industria e xhamit të sheshtë mbulon prodhimin e fletëve të xhamit për përdorim në ndërtim, tabakëve të xhamit si dhe xhamit të mbështjellë që përdoret në proçset e tjera në ndërtesa.

Fletët e xhamit tregtohen si material bazë ose për përpunim të mëtejshëm nga një numër i madh kompanish të pavarura që përfaqësohen nga shoqëria evropiane e prodhuesve të xhamit të sheshtë GEPVP, tregtarët dhe përpunuesit EAFTP dhe vendosësit UEMV.

2. PËRFITIMET E PRITËSHME NGA PUNA E KT/DPS

Standardet e kësaj fushe nevojiten për të lehtësuar tregtinë rajonale dhe botërore të produkteve të Xhamit. Ato ndihmojnë për:

- mënjanimin e mosmarveshjeve midis palëve duke përdorur një terminologji të përbashkët;
- mënjanimin e keq interpretimeve duke përdorur metoda të njëjta prove dhe marje mostre të njëjtë në vlerësimin e cilësisë së produktit;
- përdorimin e metodave të njëjtja matjeje për të evituar provat e dyfishta;
- të patur proçedura të përbashkëta operacionale për të shmangur dallimet në kontrollimin e cilësisë së një produkti;
- të ndihmuar entet e specializuara kombëtare për hartimin e rregullave teknike në fushen që mbulon ky KT.

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 3/3

3 PJESMARJA NË KT/DPS

Të gjitha palët e interesuara në procesin e hartimit dhe të zbatimit të standardeve kanë të drejtë që të caktojnë ekspertët e tyre në KT të DPS si dhe në Grupet e Punës të ngritura për çështje të veçanta në mënyrë që të arihet një përfaqësim sa më e mirë i të gjithë palëve të interesuara.

4 OBJEKTIVAT E KT/DPS DHE STRATEGJITË PËR TË ARDHMEN

4.1 Objektivat e përcaktuara të KT/DPS

Bazuar në konsideratat e mësipërme si dhe në detyrimin që ka DPS për tu antarsuar me të drejta të plota në CEN, KT/DPS propozon objektivat dhe drejtimet strategjike për punën e saj të ardhshme:

- të sigurojë, për palët e interesuara, një platform të gjërë diskutimi mbi standardizimin e çdo fushe dhe sektori si dhe implementimin dhe zbatimin e standardeve evropiane;
- të adoptojë të gjitha standardet evropiane të të fushës së qelqit;
- të rishikojë standardet puro shqiptare të qelqit dhe të shfuqzojë ato standard që bien në kundërshtim me standardet evropiane EN;
- të mirmbajë dhe plotësojë databazin e DPS duke shtuar edhe qëllimin e standardit.

4.2 Identifikimi i strategjive për aritjen e objektivave të KT/DPS

Përmbushja e objektivave të KT 129 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:

CEN/TC 129 - Qelqi në ndërtim

ISO/TC 63 - Enë qelqi

ISO/TC 160 - Qelqi në ndërtim.

ISO/TC 166 - Enë qeramike, enë qelqi dhe qelqi qeramike në kontakt me ushqimin

5. Planifikimi

Për realizimin e objektivave të mësipërme ky KT bazuar në propozimin e standardeve të reja fillon punën për adoptimin e standardeve

6. Financimi

Kryetari dhe anëtarët e KT punojnë mbi baza vullnetare dhe pa pagese
Sekretari i KT është punonjës i DPS

Sekretari i KT 129

(Pëllumb METOHU)